

VENDIM
Nr.101, datë 26.5.2011

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 3, DATË 16.9.2009 “PËR CAKTIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës, të neneve 55 pika 1 dhe 21 pikat 1 dhe 2 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve, pas marrëveshjes së Kryetares së Kuvendit me Kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 3, datë 16.9.2009 “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, në pikën I bëhen këto shtesa:

I. Deputeti Aurel Bylykbashi caktohet anëtar në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Deputeti Kosta Barka caktohet anëtar në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

Deputeti Ndriçim Babasi caktohet anëtar në Komisionin për Sigurinë Kombëtare.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)